


MAREVESHJE BASHKEPUNIMI

MIDIS

UNIVERSITETIT EPOKA
Departamenti Inxhinierise se Ndertimit

&

INSTITUTIT TE NDERTIMIT
TIRANE



**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI NDËRMJET
DEPARTAMENTIT TË INXHINIERISË SË NDËRTIMIT NË UNIVERSITETIN “EPOKA”
DHE
INSTITUTIT TE NDERTIMIT TIRANE**

Kjo marrëveshje është një dokument i përgjithshëm në lidhje me bashkëpunimin ndërinstitucional midis **Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit në Universitetin “EPOKA”** (me poshte referuar si CE) licensuar me Vendim të Keshillit të Ministrave No. 281, date 12/03/2008, me seli ne rrugen Tirane-Rinas, km 12, Tirane, perfaqesuar nga **Miriam Ndini** (Pergjegjese e Departamentit te Inxhinierise se Ndertimit)

DHE

Instituti te ndertimit (me poshte referuar si Instituti) me NIPT J91912001A me seli: rruga Myslym Keta Brar Tufine Tirane perfaqesuar nga **Agron Hysenlliu** (Drejtore i Përgjithshëm)

PJESA E PARË: SYNIMI I BASHKËPUNIMIT

Synimi i kësaj marrëveshjeje është nxitja e bashkëpunimit akademik dhe profesional nëpërmjet mbështetjes së veprimtarive arsimore, kërkimore dhe profesionale ndërmjet stafit akademik dhe studentëve e punonjesve të dy institucioneve. Në këtë kuadër dhe me miratimin e të dy palëve, bashkëpunimi do të përfshijë çdo fushë, e cila nga të dy palët gjykohet si e dëshirueshme, e mundshme dhe që i kontribuon zhvillimit të marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve.

PJESA E DYTË: FUSHAT E BASHKËPUNIMIT

Në përputhje me përshtatshmërinë e mjeteve buxhetore dhe me miratimin e CE dhe Institutit, fushat specifike të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm me:

1. Shkëmbimin e stafit akademik dhe profesional (teknik);
2. Zhvillimin e veprimtarive të përbashkëta kërkimore-shkencore;
3. Pjesëmarrjen në seminare dhe takime akademike, kërkimore-shkencore dhe profesionale;
4. Shkëmbimin e materialeve akademike, kërkimore-shkencore dhe profesionale, si dhe të informacioneve të tjera;
5. Organizimin e programeve akademike, kërkimore-shkencore dhe profesionale;
6. Nga të dy palët, mund të iniciohen dhe zhvillohen projekte kombëtare dhe ndërkombëtare me institucionet qeveritare dhe jo-qeveritare, duke përdorur burimet e brendshme të të dy palëve, pa përjashtuar dhe mundësinë e financimit nga burime të treta;
7. Ofrimi i ekspertizën nga ana e stafit akademik ne ceshtjet dhe problematika teknike.
8. Mundësimin e kryerjes së praktikave laboratorike (pune laborator) për studentët e regjistruar në programin “Bachelor”, CE.
9. Mundësimin e kryerjes së temës së diplomës për studentët e regjistruar në programin e studimit “Master i Shkencave” të ofruar nga CE, duke konsideruar mundësimin e përfshirjes së këtyre studentëve në projekte të ndryshme të zbatuara nga Instituti.



10. Mundësimin e kryerjes së praktikës mësimore (internship) për studentët e regjistruar në vitin e fundit të programit të studimit “Bachelor” si dhe për studentët e regjistruar në programin e studimit “Master Profesional” të ofruara nga CE.
11. Mundësimin e kryerjes së experimenteve dhe testeve laboratorike për studentët e regjistruar në programin e Doktoratures të ofruar nga CE.

Detajet e kësaj asistence të ndërsjellë dhe buxheti i nevojshëm për çdo veprimtari specifike që do të zbatohet në kuadër të kësaj marrëveshjeje do të diskutohet dhe do të miratohet me shkrim nga të dy palët para fillimit të një programi ose veprimtarie të veçantë. Detajet e këtyre programeve ose veprimtarive do të negociohen çdo vit.

Seicili nga institucionet do të përcaktojë një person bashkërendues, i cili do të sigurojë zhvillimin si dhe bashkërendimin e programeve dhe veprimtarive specifike.

PJESA E TRETË: RINOVIMI, PËRFUNDIMI DHE AMENDIMI I MARRËVESHJES

Kjo marrëveshje do të qëndrojë në fuqi për një periudhë pesë (5) vjeçare që nga data e firmës së fundit, por palët kanë rënë dakord që marrëveshjes mund t'i jepet fund nga secila palë, me kusht që pala tjetër të njoftohet me shkrim jo më vonë se muaji Mars i çdo viti. Kohëzgjatja e marrëveshjes mund të zgjatet me miratimin e të dy palëve.

Kjo marrëveshje mund të amendohet nëpërmjet shkëmbimit të letrave nga të dy institucionet. Pas miratimit zyrtar nga të dy institucionet, amendamentet do të bëhen pjesë e kësaj Marrëveshjeje të Bashkëpunimit.

Për sa më sipër, palët kanë firmosur këtë dokument:

Për: Departamentin e Inxhinierisë së Ndërtimit në Universitetin “EPOKA”



Assoc. Prof. Dr. Miriam NDINI
Përgjegjëse e Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit

Data:

Për: Institutin e Ndërtimit



Ing. Agron HYSENLIU
Drejtor i Përgjithshëm
Data: